



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 47, datë 09.07.2026

PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 34, DATË 12.06.2026 “PËR MIRATIMIN E HARTËS SË VENDQËNDRIMEVE TË MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDOREVE TË LËVIZJES SË TYRE NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar sipas relacionit përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 12.06.2026 “Për miratimin e hartës së vendqëndrimeve të mjeteve lundruedhe korridoreve të lëvizjes së tyre në territorin e bashkisë Durrës”.
2. Miratimin e shtesës së vendqëndrimit të ri në plazhin e Gjirit të Lalëzit me koordinatat gjeografike E:458947.17 m dhe N:4600295.20 m, sipas dokumentacionit bashkëlidhur vendimit.



3. Ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, pranë Bashkisë Durrës për ndjekjen e procedurave të mëtejshme sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE

Demisa Luarasi



U shpall sot me datë 10.07.2026



Monitorimi i Bregdetit 2026

Tipologjia

-  E MENAXHUAR
-  E MENAXHUAR INV. STRATEGJIK
-  KONTRATË
-  PUBLIKE
-  PUBLIKE E TARIFUAR NGA NJVV

ASFG Harta e vendqendrimeve 2026



Monitorimi i Bregdetit 2026

Tipologjia

-  E MENAXHUAR  E MENAXHUAR INV. STRATEGJIK  KONTRATË  PUBLIKE
 PUBLIKE E TARIFUAR NGA NJVV





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 537 prot.
113

Durrës, më 14 . 07 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS ✓

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.47 datë 09.07.2026 “Për miratimin e një shtese më vendimin e Këshillit Bashkiak nr.34, datë 12.06.2026 “Për miratimin e hartës së vendqëndrimeve të mjeteve lundruese dhe korridoreve të lëvizjes së tyre në territorin e Bashkisë Durrës.”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ADRIAN GURRA